



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E FINANCEVE DHE EKONOMISE
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA PROFESIONALE "STILIANO BANDILLI"
BERAT**



Nr. 228 Prot.

Berat më 28 / 08 / 2023

Lënda: Njoftim për lëvizje paralele

Drejtuar :

**DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË MARDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

Në zbatim të Ligjit Nr.15/2019 " Për nxitjen e Punësimit „ Ligjit Nr.15/2017“Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë“, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive“, Urdhëzimit nr 14, datë 27.05.2021 " Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe të formimit profesional“, Kreu XXI, Neni 108. " Lëvizja paralele e personelit mësimdhënës në ofruesit publikë të AFP- së.

Shkolla e mesme profesionale " Stiliano Bandilli", ju njofton krijimin e vendit të lirë të punës për pozicionin "Mësimdhënës i praktikës profesionale", dega "Mekanikë", (me kohë të plotë).

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar
- b) të jetë në kushte shëndetsore që e lejojnë të kryejë detyrën
- c) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar
- e) të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit
- f) të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit

Alikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) të ketë diplomë të paktën nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë me kualifikimin profesional (dega Mekanikë)
- b) të ketë të paktën 3 (tre) vjet përvojë pune në fushën në të cilën ka kryer studimet
- c) të njohë, të përdorë teknologjinë e informacionit

2. Dokumentat e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) letërmotivimin për pozicionin
- b) jetëshkrimin(CV)
- c) kartën e identitetit
- d) diplomën
- e) librezën e punës
- f) çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV
- g) certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit
- h) vërtetimin e gjendjes shëndetsore
- i) vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- j) vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi
- k) të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm

Të gjitha dokumentat duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në zyrën e protokollit të shkollës, brenda datës 06.09.2023 (5 ditë pune nga publikimi i shpalljes).

Drejtor i shkollës

Ing. Kozeta Nushi

